

**BASHKIA E TIRANËS**

Drejtuar: Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Sireta 2 F” shpk dhe “Artyka” II shpk.

Adresa: Lagjia “Babrru - Fushë”, Njësia Paskuqan, Tiranë

Rruga e Mirasit, Km i I, pranë ish Nyjes së Inerteve, Bilisht, Korçë

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksion i infrastrukturës rrugore të bllokut që kufizohet nga rruga ”Besa” – ”Siri Kodra” – ”Zenel Bastari” – ”Haki Rexhep Kodra” (përfshin dhe rrugën tek Nish Kimike).

Fondi limit: 160,045,913 (njëqind e gjashtëdhjetë milion e dyzet e pesë mijë e nëntëqind e trembëdhjetë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2017, miratuar me VKB Nr. 84, datë 29.12.2016, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017 – 2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”.

Kohëzgjatja e kontratës: 8 (tetë) muajkalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 28.4.2017, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 14 datë 10.04.2017.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme   
Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Albavia” Sh.p.k. NUIS J81527001Q

Vlera e ofertës = 136,140,178 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milion e njëqind e dyzet mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “BE-IS” shpk NUIS K71412003A

Vlera e ofertës = 122,050,940 (njëqind e njëzet e dy milion e pesëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Curri” shpk NUIS J67902718S

Vlera e ofertës = 134,664,788 (njëqind e tridhjetë e katër milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

4. Bashkimi i Operatoreve “Delta Lavori SPA” Shpk & “Company Riviera 2008 Sh.p.k  
NUIS L62415021P & NUIS K81716011V

Vlera e ofertës = 153,096,684.74 (njëqind e pesëdhjetë e tre milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër pikë shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “Euroteorema Peqin” shpk. NUIS J61905050M

Vlera e ofertës = 127,000,000 (njëqind e njëzet e shtatë milion ) lekë pa TVSH.

6. Bashkimi Operatoreve ekonomik “KACDEDJA“ Sh.p.k dhe “Agri Konstruktion” sh.pk.  
NUIS K51712017A & NUIS K01725001F

Vlera e ofertës =128,036,741 (njëqind e njëzet e tete milion e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e dyzet e një) lekëpa TVSH.

7. Bashkim Operatoresh Mela & Alb Shpresa Sh.p.k  
NUIS K62320011G & NUIS J72110003F

Vlera e ofertës =130,000,000 (njëqind e tridhjetë milion) lekëpa TVSH.

8. Bashkimi i Operatoreve ekonomik "SIRETA 2F"sh.p.k dhe “Artyka” II shpk.  
NUIS K51501008J & NUIS K26625603U

Vlera e ofertës =133,333,333 (njëqind e tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekëpa TVSH.

9. Operatori ekonomik “Victoria Invest” shpk  
NUIS K32712206U

Vlera e ofertës =147,228,626.21 (njëqind e dyzet e shtate milion e dyqind e njëzet e tete mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë pike njëzet e një) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “Albavia” shpk NUIS J81527001Q

- Operatori ekonomik “Albavia” Sh.p.k. për të vërtetuar përvojën e suksesshme ka paraqitur kontraten e punës me objekt: “Rikonstruktion i rrugës Ura Vajgurore – Pashalli-Bistrovice”. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për punimet e ngjashme, konstatoi se Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Akt-Kolaudimi, për objektin e sipërcituar, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1, si dhe situacionet përfundimtare janë paraqitur në gjuhë të huaj cka bie në kundërshtim me kushtin e përcaktuar në DST: “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”.
- Operatori ekonomik “Albavia” Sh.p.k. për të vërtetuar përvojën e suksesshme ka paraqitur tjetër kontrate e pune me objekt: “Rikonstruktion i rrugës nacionale Dajc”. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për kete objekt, konstatoi se Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Akt-Kolaudimi, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1, si dhe situacionet përfundimtare janë paraqitur në gjuhë të huaj cka bie në kundërshtim me kushtin e përcaktuar në DST: “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”.
- Operatori ekonomik “Albavia” Sh.p.k. për të vërtetuar përvojën e suksesshme ka paraqitur kontraten e punës me objekt: “Ndërtim Rruge By Pass Plepa- Rrogozhine, Loti 7 ”. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për punimet e ngjashme, konstatoi se Operatori ekonomik nuk ka paraqitur kontratën e plotë, si dhe

mungon Çertifikata e marrjes në dorëzim për këtë objekt, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1.

- Shoqëria “Albavia” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar pranë shoqërisë minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda cka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.
- Shoqëria “Albavia” shpk nuk ka paraqitur grafikun e punimeve , sic është specifikuar në Dokumentat Standarte të Tenderit shtojca 12, që Operatori Ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit në afatin kohor të përcaktuar.

### 2. Operatori ekonomik “BE-IS” shpk

NUIS K71412003A

- Operatori ekonomik “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 4 të Kapacitetit teknik: “Një punësim mesatar i të paktën 70 (shtatëdhjetë) personave, për periudhën Shkurt 2016 - Shkurt 2017 të vërtetuar me...”, pasi rezulton të ketë të nënshkruara me Bashkinë Tiranë , 3 kontrata respektivisht me objekt: 1. “Rikualifikim urban i bllokut nr.1 Laprake, kufizuar nga rruga Don Bosko - Shina e Trenit Finlanto - Turhan Pashë Përmeti - Ibrahim Pashë Bushatlliu - Lord Bajrom - Riza Cuka - Learton Vathi - Pandi Dardha - Dritan Hoxha “në të cilën ka të angazhuar 60 punonjës, 2. “Rikonstruksion i rruges se Zallit" në të cilën ka të angazhuar 23 punonjës, 3. “Rruga për në fshatin Kasallë (degëzimi nga Cerkezi-Cinan), rreth 2 km” në të cilën ka të angazhuar 24 punonjës. Për periudhën Shkurt 2016 - Shkurt 2017, ky operator ekonomik posedon një punësim mesatar prej 113 punonjësish dhe duke përjashtuar numrin e punonjësve të angazhuar në kontratat e sipërcituara, numri i punonjësve të pa angazhuar rezulton i pamjaftueshëm.
- Operatori ekonomik “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit teknik: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9)/Autobitumatrice”, pasi për mjetin Autobitumatrice të deklaruar në Shtojcën 9 ka paraqitur me faturë dhe jo dokumentacionin përkatës si dhe foto ku të evidentohet targa e mjetit.
- Operatori ekonomik “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit teknik: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9)/Autobot Uji”, pasi mjeti i deklaruar në Shtojcën 9 si Autobot me targë AA183AK i marrë me qera sipas kontratës së qerasë Nr 3769.Rep, Nr.866.Kol, datë 26.08.2016, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton të jetë kamion. Mjeti me targë AA968JL i marrë me qera sipas kontratës së qerasë Nr 111.Rep, Nr.46.Kol, datë 10.01.2017, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton të jetë Autobot karburanti i certifikuar për transport mallrash të rrezikshme brenda vendit.

### 3. Operatori ekonomik “Curri” shpk

NUIS J67902718S

- Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit teknik: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, 1 (një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, *Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm*”, pasi për mjeken e shoqërisë nuk ka paraqitur Librezën e Punës dhe CV.

- Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson pikën 16, germa d) të Kapacitetit teknik: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.”*, pasi për Autobotin me targë SH4082E nuk ka paraqitur foto.
- Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit teknik: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)/Autobot Uji”*, pasi për Autobotin me targë TR9983R të deklaruar në shtojcën 9 si i marrë me qera sipas kontratës së qerasë me “Babasi CO” shpk, Nr.23Rep, Nr.16 Kol, datë 18.02.2017, nuk ka paraqitur dokumentacion.
- Për të vërtetuar përvojën e suksesshme, shoqëria “Curri” shpk, ka paraqitur kontratat e punës si më poshtë vijon:
  - 1) Kontrata e punës me objekt: *“Rikonstruksioni I rrugës Libonik-Rrëmbec-Plase, qarku Korce”*, për të cilën nuk ka paraqitur Aktin e Kolaudimit.;
  - 2) Kontrata e punës me objekt: *“Rikonstruksioni i rrugës Porcelan-Kionostudio-Surrel”*, për të cilën nuk ka paraqitur Çertifikatën e marrjes në dorëzim;
  - 3) Kontrata e punës me objekt: *“Plotësimi i segmentit Dragobi-Valbonë”*, për të cilën nuk ka paraqitur Çertifikatën e marrjes në dorëzim.
  - 4) Kontrata e punës me objekt: *“Rikualifikim urban I zonës që kufizohet me rrugën e Durrësit, Teodor keko, Lumi Lana, Anesti Lubonja si dhe parku tek ish pista e aviacionit, njësia bashkiake Nr. 7”*, për të cilën nuk ka paraqitur Formularin e Vleresimit dhe Çertifikatën e marrjes në dorëzim.
- Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk ka paraqitur foto për çdo mjet të deklaruar sipas Shtojcës 9, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “d”.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se mjeti Autobotumatriçe e deklaruar në Shtojcën 9, nuk është e shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar: Leje qarkullimi, Çertifikatën e kontrollit teknik si dhe siguracionin e mjetit, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “a”.

4. Bashkimi i Operatoreve “Delta Lavori SPA” Shpk & “Company Riviera 2008 Sh.p.k.  
NUIS L62415021P &NUIS K81716011V

- Referuar Shtojcës 9, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Delta Lavori S.P.A” Degë e shoqërisë së huaj & “Company Riviera 2008” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) Kamiona vetshkarkues minimum 20 Ton përkatësisht me targa AA 451 MF si dhe AA 753 LO. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqëruar për mjetet e deklaruar si më lart, konstatoi se mjetit me targa AA 753 LO i ka skaduar Çertifikata e kontrollit teknik më datë 14.04.2017, ndërsa Siguracioni i mjetit ka humbur vlefshmërinë më datë 13.04.2017. Për sa më lart, duke qene se afati i fundit per dorezimin e ofertave per proceduren e prokurimit me objekt: *“Rikonstruksion i infrastrukturës rrugore të bllokut që kufizohet nga rruga ”Besa” – ”Siri Kodra” – ”Zenel Bastari” – ”Haki Rexhep Kodra” (përfshin dhe rrugën tek Nish Kimike) ka qene data 02.05.2017, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se Çertifikata e kontrollit teknik si dhe Siguracioni i mjetit me targa AA 753 LO nuk janë të vlefshme, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “a”. Si rrjedhojë, Bashkimi i Operatorëve ekonomik referuar dokumentacionit shoqëruar, nuk disponon 2 (dy) kamiona vetshkarkues minimum 20 Ton, çka*

bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16 ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 2 (dy) Kamiona Vetshkarkues minimum 20 Ton”*.

- Gjithashtu referuar Shtojcës 9, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Delta Lavori S.P.A” Degë e shoqërisë së huaj & “Company Riviera 2008” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobot Uji me targa TR 4812 T. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues, konstatoi se mjeti i deklaruar është mjet për transport karburanti, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16 ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 1 (një) Autobot uji”*.
- Sa më sipër Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Delta Lavori S.P.A” Degë e shoqërisë së huaj & “Company Riviera 2008” shpk nuk ka kapacitetin e duhur teknik, pasi nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16. Në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma (c) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se të gjitha dokumentat e paraqitura nga shoqëria “Delta Lavori S.P.A” Degë e shoqërisë së huaj nuk janë të certifikuara me vulën “Apostille” cka bie në kundërshtim me Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për “Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”.

#### 5. Operatori ekonomik “Euroteorema Peqin” shpk. NUIS J61905050M

- Shoqëria “Euroteorema Peqin” shpk referuar QKR rezulton se ka një adresë të ushtrimit të aktivitetit të saj edhe në Bashkin Kamëz. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Shoqëria “Euroteorema Peqin” shpk nuk ka parqitur Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Bashkia Kamëz për vitin 2016, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 3.
- Operatori ekonomik “Euroteorema Peqin” shpk disponon vetëm 1 (një) Autobetoniere, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, në të cilën ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 2 (dy) Autobetoniere”*.
- Në pikën 16 të kapacitetit teknik të kriterëve të Vecanta të Dokumentave Standartë të Tenderit është kërkuar *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9;), Autobot Uji-1 copë”*. Operatori ekonomik “Euroteorema Peqin” shpk në deklaratën mbi Disponimin e makinerive automjetin me targë AA461 LR është deklaruar Autobot uji, por nga verifikimi i dokumentave rezulton kamion në të cilin është montuar depozitë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16.
- Operatori ekonomik “Euroteorema Peqin” nuk ka paraqitur list-pagesat e punonjësve sipas formatit të kërkuar për muajin Shkurt 2017, cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, me pikën 4, gërma b).

- Nuk përmbush pikën 16 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit ku është kërkuar “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)”, Fadromë me Gome, 1 copë, në pronësi ose qera, pasi fadroma e deklaruar në Shtojcën 9 nuk ka dokumentacionin teknik siç kërkohet në pikën 16, gërma a), b) dhe c) të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit.
6. Bashkimi i Operatoreve ekonomik “KACDEDJA “ Sh.p.k dhe “Agri Konstruksion” sh.pk. NUIS K51712017A & NUIS K01725001F
- Shoqëria “Kacdedja” shpk ka paraqitur Certificate ISO 9001:2008 me afat vlefshmërie deri me date 23.04.2017. Duke qene se afati i fundit per dorezimin e ofertave per proceduren e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i infrastrukturës rrugore të bllokut që kufizohet nga rruga ”Besa” – ”Siri Kodra” – ”Zenel Bastari” – ”Haki Rexhep Kodra” (përfshin dhe rrugën tek Nish Kimike) ka qene data 02.05.2017, Komisioni i Vleresimit te Ofertave konkludoi se kjo certificate eshte e pavlefshme, pasi ka skaduar afati i vlefshmerise se saj. Per sa me lart shoqeria “Kacdedja” shpk nuk ploteson Kriteret e Vecanta te Kualifikimit te vendosura ne DST, Kapaciteti Teknik, pika 9.
  - Shoqëria “Kacdedja” shpk ka paraqitur Certificate ISO 14001:2004 me afat vlefshmërie deri me date 23.04.2017. Duke qene se afati i fundit per dorezimin e ofertave per proceduren e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i infrastrukturës rrugore të bllokut që kufizohet nga rruga ”Besa” – ”Siri Kodra” – ”Zenel Bastari” – ”Haki Rexhep Kodra” (përfshin dhe rrugën tek Nish Kimike) ka qene data 02.05.2017, Komisioni i Vleresimit te Ofertave konkludoi se kjo certificate eshte e pavlefshme, pasi ka skaduar afati i vlefshmerise se saj. Per sa me lart shoqeria “Kacdedja” shpk nuk ploteson Kriteret e Vecanta te Kualifikimit te vendosura ne DST, Kapaciteti Teknik, pika 10.
  - Shoqëria “Kacdedja” shpk ka paraqitur Certificate OHSAS 18001:2007 me afat vlefshmërie deri me date 23.04.2017. Duke qene se afati i fundit per dorezimin e ofertave per proceduren e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i infrastrukturës rrugore të bllokut që kufizohet nga rruga ”Besa” – ”Siri Kodra” – ”Zenel Bastari” – ”Haki Rexhep Kodra” (përfshin dhe rrugën tek Nish Kimike) ka qene data 02.05.2017, Komisioni i Vleresimit te Ofertave konkludoi se kjo certificate eshte e pavlefshme, pasi ka skaduar afati i vlefshmerise se saj. Per sa me lart shoqeria “Kacdedja” shpk nuk ploteson Kriteret e Vecanta te Kualifikimit te vendosura ne DST, Kapaciteti Teknik, pika 11.
  - Shoqëria “Kacdedja” shpk ka paraqitur Certificate PASS 99:2012 me afat vlefshmërie deri me date 23.04.2017. Duke qene se afati i fundit per dorezimin e ofertave per proceduren e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i infrastrukturës rrugore të bllokut që kufizohet nga rruga ”Besa” – ”Siri Kodra” – ”Zenel Bastari” – ”Haki Rexhep Kodra” (përfshin dhe rrugën tek Nish Kimike) ka qene data 02.05.2017, Komisioni i Vleresimit te Ofertave konkludoi se kjo certificate eshte e pavlefshme, pasi ka skaduar afati i vlefshmerise se saj. Per sa me lart shoqeria “Kacdedja” shpk nuk ploteson Kriteret e Vecanta te Kualifikimit te vendosura ne DST, Kapaciteti Teknik, pika 12.
7. Bashkim Operatoresh Mela & Alb Shpresa Sh.p.k NUIS K62320011G&NUIS J72110003F

- Për të vërtetuar përvojën e suksesshme, shoqëria “Alb Shpresa” shpk, ka paraqitur kontratat e punës si më poshtë vijon:
  - Kontrata e punës me objekt: “Ndërtim Ura Mat”, për të cilën nuk ka paraqitur Çertifikatën e marrjes në dorëzim;
  - Kontrata e punës me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Shëngjin-Kume”, për të cilën nuk ka paraqitur Aktin e Kolaudimit.
- Gjithashtu Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Mela.” shpk & “Alb Shpresa” shpk ka paraqitur kontratën e punës me objekt: “Sistemim asfaltimi i rrugëve të fshatrave Barake & Koxhas” me vlerë 50,507,014 (pesëdhjetë milion e pesëqind e shtatë mijë e katërbëdhjetë) lekë pa TVSH.
- Për sa më lart, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Mela.” shpk & “Alb Shpresa” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1 gërma “a” si dhe pikën 1 gërma “b”.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Mela.” shpk & “Alb Shpresa” shpk ka deklaruar se ka pjesë të stafit 1 (një) punonjës teknik ndërtimi. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, konstatoi se punonjësi rezulton të jetë Teknik Topograf dhe jo Teknik Ndërtimi, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6 ku ndër të tjera përcaktohet se: *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi 2 (dy) punonjës të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, nga të cilët:*
  - *1 (një) elektrikist*
  - *1 (një) teknik ndërtimi”.*
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për kamionat vetshkarkues të deklaruar sipas Shtojcës 9 nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik, konstatoi se asnjë nga mjetet nuk plotëson tonazhin e kërkuar minimumi 20 Ton, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 2 (dy) kamiona vetshkarkues minimumi 20 Ton”.*
- Sa më sipër Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Mela.” shpk & “Alb Shpresa” shpk nuk ka kapacitetin e duhur teknik, pasi nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16. Në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma (c) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatoreve ekonomik "SIRETA 2F"sh.p.k dhe "Artyka" II shpk, me adresë:Lagjia "Babrru - Fushë", Njësia Paskuqan,Tiranëse oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 133,333,333(njëqind e tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekëpa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi “Skënderbej”, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar , oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 147,228,626.21 (njqind e dyzet e shtate milion e dyqind e njezet e tete mije e gjashtëqind e njezet e gjashte pike njezet e nje) lekëpa TVSH, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë:12.05.2017

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, janë paraqitur Formularët e Ankesës nga Operatori ekonomik “Victoria Invest” shpk, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 18799 Prot. datë 16.05.2017, nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik "SIRETA 2F"sh.p.k dhe “Artyka” II shpk, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 20037. Prot. datë 19.05.2017, nga Operatori ekonomik “Curri” shpk, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 18765. Prot. datë 16.05.2017, nga Operatori ekonomik “Albavia” shpk, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 20409. Prot. datë 22.05.2017 (administruar në dosjen e prokurimit), në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i infrastrukturës rrugore të bllokut që kufizohet nga rruga ”Besa” – ”Siri Kodra” – ”Zenel Bastari” – ”Haki Rexhep Kodra” (përfshin dhe rrugën tek Nish Kimike)”.

Me marrjen e ankesave nga Operatorët ekonomikë të mësipërm në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 ”Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) me Urdhërin me Nr. 18824.Prot. dt. 16.05.2017 është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar) me Urdhërin me Nr. 18826.Prot. datë 16.05.2017 u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave, i cili pasi u njoh me pretendimet e Shoqërisë “Victoria Invest” shpk ku konkludoi me pranimin e pjesshëm të ankesës, duke i kthyer pergjigje me shkresen me Nr. 18799/2 Prot, datë 22.05.2017, pretendimet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik "SIRETA 2F"sh.p.k dhe “Artyka” II shpk, ku konkludoi me mos pranimin e ankesës, duke i kthyer pergjigje me shkresen me Nr. 20037/2 Prot, datë 22.05.2017, pretendimet e Shoqërisë “Curri” shpk ku konkludoi me mos pranimin e ankesës, duke i kthyer pergjigje me shkresen me Nr. 18765/2 Prot, datë 22.05.2017, pretendimet e Shoqërisë “Albavia” shpk ku konkludoi me mos pranimin e ankesës, duke i kthyer pergjigje me shkresen me Nr. 20409/2 Prot, datë 24.05.2017, (administruar ne dosjen e prokurimit).

Në vijim jemi vënë në dijeni me anë të shkresës me Nr. 1039/1 Prot. datë 02.06.2017 hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën me Nr. 22133 Prot. dt. 05.06.2017 se Shoqëria ”Curri” shpk ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, gjithashtu me anë të shkresës me Nr. 1049/1 Prot. datë 05.06.2017 hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën me Nr.



22297 Prot. dt. 06.06.2017 se Shoqëria "Victoria Invest" shpk ka ushtruar të drejtën e ankimimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik si dhe me anë të shkresës me Nr. 1055/1 Prot. datë 05.06.2017 hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën me Nr. 22298 Prot. dt. 06.06.2017 Bashkimi i Operatoreve ekonomik "SIRETA 2F"sh.p.k dhe "Artyka" II shpk ka ushtruar të drejtën e ankimimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, referuar procedurës së prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i infrastrukturës rrugore të bllokut që kufizohet nga rruga "Besa" – "Siri Kodra" – "Zenel Bastari" – "Haki Rexhep Kodra" (përfshin dhe rrugën tek Nish Kimike)", (administruar ne dosjen e prokurimit). Komisioni i Prokurimit Publik nëpërmjet shkresave të sipërcituara i ka kërkuar Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Tiranë, informacion të detajuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Bashkia Tiranë me anë të shkresave me Nr. 22153/1 Prot, datë 06.06.2017, Nr. 22297/1.Prot, datë 07.06.2017, Nr. 22298/1.Prot, datë 07.06.2017 i ka i vënë në dispozicion Komisionit të Prokurimit Publik, të gjithë informacionin e kërkuar në lidhje me ecurinë e kësaj procedure prokurimi.

Për sa më sipër në përgjigje të shkresës "Dërgim Vendimi" me Nr. 583/1 Prot., datë 28.07.2017, hyrë në Bashkinë e Tiranës me Nr. 29249 Prot., datë 04.08.2017 (administruar në dosjen e prokurimit), jemi vënë në dijeni se Komisioni i Prokurimit Publik ka pranuar ankesën e bërë nga Bashkimi i Operatoreve ekonomik "SIRETA 2F"sh.p.k dhe "Artyka" II shpk, shoqëria "Victoria Invest" shpk dhe nuk ka pranuar ankesën e bërë nga shoqëria "Curri" shpk. Në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik me Nr. 583/2017 datë 28.07.2017, riklasifikimi dhe renditja perfundimtare është si më poshtë vijon:

- Bashkimi i Operatoreve ekonomik "SIRETA 2F"sh.p.k dhe "Artyka" II shpk kualifikohet në vend të parë.

Çmimi total i ofertës pa tvsh = 133,333,333 (njqind e tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mije e treqind e tridhjetë e tre) lekë. Çmimi total i ofertës me tvsh = 160,000,000 (njqind e gjashtedhjetë milion) Lekë. Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 8 (tetë) muajve kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

- Operatori ekonomik "Victoria Invest" shpk kualifikohet në vend të dytë.

Çmimi total i ofertës pa tvsh = 147,228,626.21 (njqind e dyzet e shtate milion e dyqind e njezet e tete mije e gjashteqind e njezet e gjashte pike njezet e nje) lekë. Çmimi total i ofertës me tvsh = 176,674,351.46 (njqind e shtatedhjetë e gjashte milion e gjashteqind e shtatedhjetë e kater mijë e treqind e pesedhjetë e nje pike dyzet e gjashte) Lekë. Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 8 (tete) muajve kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Nuk kualifikohen Operatorët e mëposhtem ekonomik:

- Operatori ekonomik "Albavia" Sh.p.k
- Operatori ekonomik "BE-IS"Sh.p.k
- Operatori ekonomik "Curri" Sh.p.k
- Bashkimi i Operatoreve ekonomik "Delta Lavori SPA" Shpk & "Company Riviera 2008 Sh.p.k
- Operatori ekonomik "Euroteorema Peqin" Sh.p.k
- Bashkimi i Operatoreve ekonomik "KACDEDJA" Sh.p.k dhe "Agri Konstruksion" sh.pk.
- Bashkim Operatoresh Mela & Alb Shpresa shpk

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në mbështetje të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), Kreu VII, Neni 67, vendosi të njoftojë menjëherë operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi në lidhje me rivlerësimin dhe riklasifikimin e deklaruar më sipër, i cili u pasqyrua në faqen elektronike të APP- së me datë 09/08/2017.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender, në lidhje me rivlerësimin dhe riklasifikimin e deklaruar më datë 09.08.2017, në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.